



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Përmblenë/Prodato Received/Delivery	21.05.2021	1	viti god year
Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojtja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSTHCK	2581/2021		1/9.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.255/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shaban, anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.255/2021 të datës 07.04.2021 të parashtruar nga ankuesja me adrese banimi Rr. "Shaqir Igrishta", Kompleksi Dafina, Hyrja 2/3, Nr.10, Prishtinë, kundër organit të punësimit Komisioni i Pavarur i Mediave, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës-pushim pa pagesë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 21.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.255/2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër të referencës 2103/313/EXD/LL i datës 11.03.2021 i Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur për Media.
- III. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i Komisionit të Pavarur për Media që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm për nëpunësit civil, të rishqyrtoj kërkesën e datës 10.02.2021 të parashtruar nga
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja Zyrtare e Lartë për Monitorim Regjional, në Komisionin e Pavarur për Media, me datë 07.04.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1637/2021 të regjistruar me

numër A.nr.255/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër 2103/313/ExF/II të datës 11.03.2021 të Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur për Media, për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.04.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komisioni i Pavarur për Media. Këshilli me datën 19.04.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë me numër protokollit 1871/2021 nga Komisioni i Pavarur për Media se bashku me provat e lëndës nga fq.1/16.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës pasi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet për pranueshmerinë e ankesës siç përcaktohet me nenin 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 07.04.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Kryeshefes Ekzekutive të Komisionit të Pavarur për Media e datës 25.10.2018; Vërtetimin e datës 05.03.2020 për statusin e studimeve; Vendimin e datës 11.03.2021 të Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur për Media; Kërkesën e ankueses të datës 11.05.2021 me numër të protokollit 2315/2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit e ankueses të datës 02.08.2011; Përshkrimin e detyrave të punës i datës 15.09.2011; Kërkesën e ankueses të datës 10.02.2021 e parashtruar në Komisionin e Pavarur për Media për pushim pa pagesë; Rekomandimi i datës 03.03.2021 i Udhëheqëses së Divizionit për Monitorim dhe Analizë i Komisionit të Pavarur për Media; Vendimin e datës 09.07.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komisionit të Pavarur për Media; e-mailin e datave 02.03.2020, 04.03.2020, 12.03.2020 dhe 16.03.2020; Kërkesën e ankueses për pushim pa pagesë e datës 02.03.2020; Vendimin e datës 25.10.2018 e Kryeshefes Ekzekutive të Komisionit të Pavarur për Media; Kërkesa e ankueses e datës 16.10.2018 për pushim pa pagesë e parashtruar në Komisionin e Pavarur për Media; e-mail i datave 16.10.2018, 23.10.2018 dhe 24.10.2018; Vendimine datës 23.03.2020 të Kryeshefes Ekzekutive të Komisionit të Pavarur për Media si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe pas analizimit të provave të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankueses është e bazuar, *sepse*:

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës gjegjësisht sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2011, Kolegji ka konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës Zyrtare e Lartë për Monitorimin Regjional, në Departamentin për Monitorim dhe Analizë pranë Komisionit të Pavarur për Media. E njëjta me datë 10.02.2021 ka parashtruar kërkesë të Eprori i saj gjegjësisht të Udhëheqësi i Departamentit për Monitorim dhe Analizë, për aprovim të kërkesës për pushim pa pagesë për arsye të vazhimit të studimeve master, në Universitetin e Evropës Juglindore të Tetovës, Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore në programin-studime të Diplomacisë.

Kryshefi Ekzekutivi i Komisionit të Pavarur për Media, me Vendimi me numër 2103/313/EXF/LL të datës 11.03.2021, ka refuzuar kërkesën e ankueses për pushim pa pagesë të datës 10.02.2021, me arsyetimin se Udhëheqësi i ankueses ka rekomanduar mos aprovimin e kërkesës në fjalë për shkak

të numrit të vogël të stafit në Departamentin e Monitorimit dhe Analizës, pamundësisë së rekrutimit të stafit të ri si dhe aktiviteteve të planifikuara për vitin 2021 nga Departamenti i Monitorimit dhe Analizës.

Po nga shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se me Vendimin nr. ref.1810/1121/EXD/n.s.k të datës 25.10.2018, të Kryeshefes Ekzekutive të Komisionit të Pavarur për Media, ankueses i është lejuar pushim pa pagesë për periudhën nga data 01.11.2018 deri 01.11.2019, për vazhdimin e studimeve master në Universitetin Evropës Juglindore në Tetovë në drejtimin studime gjermane.

Ndërsa me datë 02.03.2020 ankuesja serish ka parashtruar kërkesë për pushim pa pagesë për arsye të vazhimit të studimeve master, në Universitetin e Evropës Juglindore të Tetovës, Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore në programin-studime të Diplomacisë, e cila kërkesë është refuzuar nga vet Kryeshefi Ekzekutiv i Komisionit të Pavarur për Media me Vendimin me numër 2003/365/EXD/II të datës 23.03.2020 si dhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit të Pavarur për Media përmes Vendimit nr.2007/544/KZKA/ni të datës 09.07.2020.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës përkatësisht nenit 40 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ku është përcaktuar se: *1.Nëpunësit civilë kanë të drejtë në: 1.4. pushim pa pagesë, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë respektivisht nenin 15 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe paragrafin 2 me të cilin është përcaktuar se : Pushimi pa pagesë mund të autorizohet në raste të veçanta nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit punëdhënës, si në vijim: 1.1. Për ngritjen profesionale për nevojat e vetë nëpunësit civil,..... 2. Pas kalimit të periudhës së pushimit pa pagesë, nëpunësi civil e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme apo ekuivalente me të, dhe si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë që të kërkoj pushim pa pagesë për arsye të ngritjes profesionale, ndërsa është në diskrecion të Udhëheqësit me të lartë të institucionit që të shqyrtoj dhe vendos lidhur me kërkesën. Me përfundimin e pushimit pa pagesë, nëpunësi civil mbanë të drejtën e kthimit në vendin e tij të punës apo në pozitë ekuivalente.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesës duke u bazuar në vlerësimin e shkresave të lëndës ka konstatuar se Kryeshefi Ekzekutiv i Komisionit të Pavarur për Media me rastin e vendosjes se kërkesës së ankueses të ditës 10.02.2021 përmes Vendimin me numër të referencës 2103/313/EXD/LL të datës 11.03.2021, nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe plotë gjendjen faktike lidhur me çështjen kontestuese, si dhe vendimi i kontestuar nuk përmbante faktet vendimtare lidhur me vendosjen e kërkesës se nëpunës civil

Po ashtu Kolegji nga analizim i shkresave të lëndës ka gjetur se pretendimet e ankueses në kërkesën e datës 10.02.2021 nuk janë të qarta dhe të mjaftueshme për vendosje dhe si të tilla janë kundërthënëse njëra me tjetrën.

Andaj bazuar në konstatimet si me lartë, Krye shefi Ekzekutiv i Komisionit të Pavarur për Media është i obliguar që brenda afatit si në dispozitiv të këtij vendimit, në pajtim me legjislacionin e shërbimit civil të shqyrtoj kërkesën e ankueses të datës 10.02.2021 si dhe të merr parasysh rekomandimet dhe pikëpamjet juridikë sipas këtij vendimi.



Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.255/2021

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Valentina Kaçandolli
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur për Media;
- Udhëheqëses së Personelit në Komisionin e Pavarur për Media dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së